e-Buletini mujor i Sekretariatit për Çështje Evropiane
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Qershor 2015

Vizitë pune nga ana e Zëvendëskryeministrit Besimi në Bruksel

Mesazhe nga Mogerini dhe Han: Respektimi I marrëveshjes së 2 qershorit dhe prioritet për reforma urgjente

Gjatë vizitës, Zëvendëskryeministri Besimi mbajti takime të ndara me Përfaqësuesen e Lartë për politikë të jashtme dhe siguri të Bashkimit Evropian, znj. Federika Mogerini, Komi sarin për politikë fqinjësore evropiane dhe negociata për zgjerim z. Johanes Han, zyrtar të nivelit të lartë dhe përfaqësues të komisionit Evropian Danielsson, Paquet dhe me euro-deputetët Vajgëll, Kukan dhe Hovit. Gjatë takimeve u bisedua për procesin e integrimit evropian të Republikës së Maqedonisë,sfidat aktuale politike me të cilat po përballemi dhe implikimet mbi procesin e integrimit evropian. Nga ana e znj. Mogerini dhe z. Han u kërkua që liderët politik në Maqedoni të respektojnë marrëveshjen e 2 qershorit për tejkalimin e krizës politike në Maqedoni,njëkohësisht nga ana e komisarit Han u kërkuan reforma urgjente me prioritet për vendin tonë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

The image cannot be displayed. Your computer may not have enough memory to open the image, or the image may have been corrupted. Restart your computer, and then open the file again. If the red x still appears, you may have to delete the image and then insert it again.

[më shumë për takimin me Komisarin Han më 17 qershor]
[më shumë për takimin me Mogerinin më 18 qershor]

Bashkëpunim bilateral

Takime Besimi - Koxias në Athinë dhe Shkup

Gjatë Takimeve u diskutuansfidat aktuale me të cilat ballafaqohen Bashkimi Evropian, Greqia dhe Republika e Maqedonisë dhe nevoja për bashkëpunim të ndërsjellë në frymën e agjendës të Selanikut, si themel për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit perëndimor në Bashkimin Evropian, dhe mundësitë për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillimor të mëtutjeshëm në më shumë fusha.

[më shumë për takimin më 24 qershor në Shkup]
[më shumë për takimin më 04 qershor në Athinë]

Ministri I Hungarisë Sijatro në takim me Besimin

Gjatë takimit, Zëvendëskryeministri Besimi shprehu falënderim për mbështetjen dhe sinqeritetin e vazhdueshëm nga ana e Hungarisë për integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe angazhimin për përshpejtimin e procesit të zgjerimit të BE-së kah vendet e Ballkanit Perëndimor.

[më shumë]
15qershor 2015

Medalje kombëtare ylli i Italisë për Besimin

Medalja jepet në bazë të Vendimit të Presidentit të Italisë Sh.T. z. Serxho Matarela, për kontributin e dhënë nga ana e Zëvendëskryeministrit Besimi në progresin e raporteve shoqërore dhe bashkëpunimit mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Italisë në procesin euro - integrues, veçanërisht gjatë kohës së kryesimit të Italisë në Këshillin e BE-së. [më shumë]
4 qershor 2015

Zbatim i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim



U mbajt mbledhja e 12-të e Komitetit për stabilizim dhe asociim mes Republikës së Maqedonisë dhe BE-së Bruksel

Komiteti për stabilizim dhe asociim shqyrtoi realizimin e kritereve politike për periudhën e kaluar, si dhe realizimin e marrëveshjes për stabilizim dhe asociim (MSA).
Takimi i Komitetit për stabilizim dhe asocim rrumbullakosi ciklin e nën-komiteteve të sektorëve të mbajtura nën MSA nga fundi i vitit 2014. Për rezultatet nga takimi i Komitetit do të njoftohet Këshilli për stabilizim dhe asociim, i cili do të mbahet më 20 korrik të vitit 2015.më shumë
17 qershor 2015

"Evropa në rajonin tim", gara e fotografisë- Komisioni Evropian Fotografo dhe ti!



Implementimi I projektit norvegjez nga ana e SÇE-së

Sekretariati për çështje evropiane (SÇE),filloi ciklin e tretë të trajnimeve të avancuara,në kuadër të projektit: Mësimi i qëndrueshëm për BE-në dhe sistemi i trajnimeve,i cili realizohet me mbështetjen e Mbretërisë së Norvegjisë.Qëllimi i këtyre trajnimeve është forcimi i kapaciteteve analitike të anëtarëve të grupeve punuese për përgatitjen e programit Kombëtar për miratimin e së drejtës Evropiane (NPAA).Trajnimet plotësohen me aktivitetet e NPAA grupeve punuese të Acquis që realizohen në kornizat e Tuining projektit në SÇE.
Gjatë muajit qershor 2015, janë realizuar trajnime për kapitujt nga NPAA:
Shkencë dhe hulumtim si dhe Ndërmarrje dhe politika industriale, Politika sociale dhe punësimi,Integriteti dhe lufta kundër korrupsionit.Programet janë realizuar nga ana e përfaqësuesve huaj të lartë.Në këto trajnime morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës, anëtarë të NPAA-së të grupeve punues, nga të cilët rreth 73 persona të cilët kanë kaluar testet e detyrueshme, do të realizojnë pjesën e dytë të programit - vizitë studimore në Bruksel, në periudhën tetor të vitit 2015 - shkurt të vitit 2016.

IPA Projekte

U mbajt debati publik për ligjin mbi lirimin me kusht dhe promovimin e shërbimit sprovues (24 qershor 2015)



Gjatëdebatit publik është bërë prezantimi i synimeve dhe rezultatet e parashikuara si pjesë e komponentit 2 të Tuining Projektit të BE-së.për mbështetje të mëtutjeshme të gjyqësisë dhe promovimin e shërbimit sprovues dhe sanksioneve të tjera alternative, lidhur me zhvillimin dhe promovimin e Shërbimit të ri të Lirimit me Kusht në vendin përfitues, pas miratimit të propozim ligjit për lirim me kusht nga Parlamenti, të cilin e përgatitën bashkërisht ekspertët e projektit dhe përfituesit kryesorë të projektit..

Financuar nga : Bashkimi Evropian- tuining projekti Qëllimi i projektit është të mbështesë edhe më tej gjyqësinë e pavarur, të besueshme, profesionale dhe efikase dhe të promovojë shërbimin sprovues dhe sanksionet alternative.
Vlera e përgjithshme: 1.070.690 Euro
Kohëzgjatja: janar 2015 - dhjetor 2016
Përfituesit kryesorë të projektit janë: Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për zbatim të sanksioneve, Gjykata Supreme, gjykatat, Zyrat Publike të Prokurorisë dhe Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.
më shumë

U mbajt stërvitja ndërkombëtare në terren IPA Kampeks (IPA CAMPEX) 2015 (15-19 qershor)

Lajme nga BE-ja

- Referendum në Greqi: Deklarata e Komisionit
- Rekomandime të PE për menaxhimin e Eurozonës
- Komisioni Evropian do të duhet ti ndërpresë harxhimet për shërbimet roaming nga qershori I vitit 2017
- Komisioni bën thirrje për një zbatim më të rreptë të legjislacionit për të drejtat e pasagjerëve në Evropë
- Luksemburgu merr Presidencën e Këshillit të BE-së
- Deputetët diskutojnë për strategjinë e BE-së për barazi gjinore
- Samiti BE-Meksikë: Modernizimi i kuadrit ligjor bilateral
- Presidenti Junker shënoi 30 vjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Shengenit
- Raport për progresin në prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme
- Bashkimi Evropian në Samitin G-7
- U prezantua programi "Horizont 2020"
- Çmimi evropian për qytetarët
- Ditët e Evropës për zhvillim

- Komisioni diskutoi për mënyrat që do të kontribuojnë në forcimin e politikës sociale të BE-së

A e dini se ...?

- Shkalla e papunësisë tek gratë është 63%, dhe dallimi i pagave mes gjinive është 16.4%, ndërsa diferenca në pensione mes gjinive mesatarisht është 39%
- Pjesëmarrja e femrave në totalin e popullsisë në Evropë është 52%, por vetëm një e treta e tyre janë të vetë-punësuara apo të punësuara në bizneset e reja në BE
- Lloji i ushqimit ekzotik nuk është përdorur në një shkallë të konsiderueshme në BE deri më 15 Maj 1997
- Ushqimi 'Tradicional' nga vendet e treta do lejohet në tregun e BE-së, me kushtin që ajo të ketë histori të provuar të konsumit të sigurt prej të paktën 25 vjetësh
- Së bashku me vendet anëtare, BE-ja është një nga donatorët më të njohur në ndihmën për zhvillim , për përkrahje të rreth 150 vendeve me të cilën do të ndihmojë të përmirësojë jetën e miliona njerëzve në botë

Datat e rëndësishme ndërkombëtare

- 11 korrik Dita Botërore e popullsisë
- 15 korrik Dita Botërore e aftësive tek të rinjtë
- 30 korrik Dita ndërkombëtare e miqësisë
- 30 korrik Dita Botërore për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Ju falënderojmë